



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPSTINA VUŠTRINA

01 Nr. / Br. 266 / 19
Nr. i fq. / Br. st. - 21 -
Data / Datum 26.09.2019

VUSHTRRI - VUŠTRIN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -VII- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 25 KORRIK 2019**

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:20.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri:
Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Basri Menxhiqi, Ermal Lahu, Fakele Dushi, Fitim Halili, Fatmire Saraçi, Faton Shabani, Fjolla Ujkani, Gentiana Rama, Gresa Muli, Habibe Gërxhaliu, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli-Latifi, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Sadije Bajgora, Safet Idrizi, Selim Rrustemi Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

Munguan: Rrezarta Krasniqi dhe Hysni Gërguri.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës -z.Xhafer Tahiri, nënkryetari i komunës Besim Muzaqi, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapë dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë prezent 33 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - pasi i përshëndeti të pranishmit diskutoi lidhur me seancën e kaluar në të cilën seancë si kurrë më parë në mënyrë të pandershme dhe me një nivel shumë të ulët, kryetari i komunës duke mos zgjedhur mjete dhe duke përdorur fjalor që nuk do duhej të ishte i një kryetari sepse ai fjalor është fjalor rrugaçësh madje kryetari tentoi që me shpifje, nënçmime e me rrenat e veta të arsyetojë edhe dështimet në qeverinë e tij në stilin sulmo, trillo, etiketo dhe ik. Kryetari në seancën e kaluar tentoi të arsyetojë dështimet ndër tjera edhe dështimin në menaxhimin e mbeturinave edhe pse i rikujtoi kryetarit se PDK i ka lënë të gatshëm projektin për menaxhimin e mbeturinave në tërë territorin e Komunës së Vushtrrisë, do të thotë edhe në fshatra dhe mu për këtë madje ka trashëguar edhe buxhetin e planifikuar për vitin 2018 në vlerë prej 630.000.00 € dhe sipas planifikimeve buxhetore është dashtë që shërbimi i mbledhjes së mbeturinave në tërë territorin e Komunës së Vushtrrisë të fillojë më 1 janar 2018 çka nuk ka pas kapacitet kjo qeveri dhe ka zvarrit fillimin e implementimit me muaj të tërë edhe pse mjete financiare i ka pas në dispozicion. Dështimet e veta në seancën e kaluar tentoi t'i mbulojë duke më

akuzuar mua kinse paskam qenë pjesë e Bordit të Drejtorëve të Kompanisë “Uniteti” çka absolut nuk është e vërtetë po edhe kjo insinuatë është e njëjta sikur shumë pretendime të rreme të kryetarit të komunës, vetëm për të arsyetuar dështimet e njëpasnjëshme. Kryetari ka zgjedh stilin e akuzave të pabaza sa herë që kërkohet llogaridhënie, sa herë që kërkohet transparencë dhe sa herë që atakohet për keqqueverisje pa pas bazë dhe çdoherë duke rrejt e trilluar. Kryetar pse po merreni me këso rrenash e trillime, a po mendoni se po ju beson dikush. Si nuk ju vjen turp të lansoni këso dezinformata kur e di ti dhe e dinë të gjithë qytetarët kush jam unë e kush je ti, ti vërtet je një grindavec që nuk meriton as respekt as nder as bashkëpunim, ti je një uzurpator i pronës komunale, ti në Agjencinë Kundër Korrupsion ke deklaruar rrejshëm, gjegjësisht nuk ke deklaruar shtëpinë tuaj në fshatin Stanoc aty ku e ke deklaruar vendbanimin në KQZ. Ke pas arsye për këtë sepse ti aty mban të uzurpuar pronën komunale dhe çdo ditë dëmton buxhetin e komunës. Kryetar pse nuk reflektoni pozitivisht pasi që aksidentalisht e din edhe ti që ke ardhur në këtë pozitë dhe unë dua të kem respekt vërtet për institucionin e kryetarit, por nga seanca e kaluar ju them se për ju nuk kam kurrfarë respekti, ju çdo ditë e më shumë po tregoni se jeni një hiç, jeni një matrapaz, jeni një tyxhar që me paratë e qytetarëve po provoni të pasuroheni në mënyrë të kundërligjshme, po edhe duke mbajtur të uzurpuar pronën komunale dhe duke aplikuar metoda perfide të korrupsionit, shantazhit, nepotizmit, harraqit, kurdisjes së tenderëve etj. Kryetar ju duhet të shkoni sa nuk është bërë vonë, ju nuk jeni kryetar i imi nuk keni kredibilitetin për ta drejtuar komunën dhe nuk ju pranoj tutje si të tillë, andaj po e kërkoj dorëheqjen tuaj sa nuk është bërë vonë sepse ju do të shkoni shpejt nga kjo pozitë po një është e sigurt me faqe të bardhë jo assesi. Jep dorëheqje fshehu dikund mos të sheh njeri se e ke bërë veten dhe na bërë horë krejt qytetin e Vushtrrisë. Ka djem e vajza të ndershëm dhe që dinë ta mbrojnë qytetin e tyre nga matrapazë, rrenacakë, haraçegji e faqezi. Ik vet mos prit ma e mbaje mend fjalën popullore “me të lidhë dikush prapë vjen dikush të zgjidh” Kryetar ti je duke e lidh veten e pastaj s’ka kush të zgjidh, merri me veti edhe ata që kanë keqpërdor e janë në klanin tuaj, liro komunën, ik më shpejt se sa më shpejt më mirë për ty, për ata e gjithsesi për qytetin dhe qytetarët e Vushtrrisë.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – adresoi shqetësimin e tij për siç tha për një parcelë që e ka historikun e vet të lavdishëm e për të cilën e dinë të gjithë. Pra bëhet fjalë për parcelën e Adem Vocës, vend ky ku Adem Voca kishte zhvilluar rezistencë luftarake kundër armikut. Por tani kjo pronë e cila ndodhet në lagjen “Dautaj”, gjendet në kontest gjyqësor gjë për të cilën është në dijeni edhe Drejtori i Drejtorisë së Pronës. Tutje shtoi se në këtë parcelë ka ekzistuar mendimi që të ndërtohet një park memorial, por në mungesë të mjeteve financiare ky projekt nuk ka mundur të jetësohet. Lidhur me këtë ai apeloj tek strukturat komunale që të kenë kujdes që kjo pronë të mos jepet në shfrytëzim për ndonjë gjë tjetër përpos që të ngritet ai park memorial.

Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së - njoftoi se si drejtori kompetente kanë bërë shikimin e gjendjes faktike të asaj parcele, dhe nga dokumentacioni kadastral ajo parcelë figuron në emër të komunës. Lidhur me këtë ai siguroi anëtarin e kuvendit z. Januzi se asnjë investim nuk ndodh pa u zhvillua një diskutim publik me banorët lokal të pronave ku investohet. Andaj edhe në rastin e parcelës ceku se nuk do të bëhen investime pa pasur një debat dhe analizë të përgjithshme lidhur me temën në fjalë.

Shkëlzen Feka, anëtar i kuvendit – duke replikuar me anëtarin e kuvendit z. Azemin vlerësoi se është i papranueshëm dhe denigrues fjalori dhe qasja e tij ndaj kryetarit të komunës. Duke e quajtur atë me emra fyes si tyxhar, grindavec dhe matrapaz, për këto ai duhet të kërkojë falje dhe të vërtetohen nëse këto gjëra a janë të vërteta apo jo.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se përkundër respektit që ka për parafolësin, vlerësoi se të gjitha ato që u thanë nga ana e tij për kryetarin e komunës janë të vërteta dhe këtë e di edhe ai vetë dhe gjithë qytetarët e Vushtrrisë. Ka qenë një fatkeqësi në zgjedhjet e fundit dhe ka dalë rezultati çfarë ka dalë, barrën do ta bartin së bashku si koalicion sepse edhe partnerët e koalicionit e dinë mirë keqpërdorimin që është duke ndodhur apo ndoshta edhe ata janë bërë pjesë e këtyre keqpërdorimeve. Lidhur me gjithë këtë ai ka bërë përgjegjës një njeri dhe ai është Xhafer Tahiri, nga ai cili nuk kërkoi të falur për gjuhën e tij sepse niveli i tij edukativ është i nivelit të ulët. Lidhur me koalicionin qeverisës vlerësoi se kjo martesë qeverisëse qoftë e zorit apo e djallit duhet të shkëputet pasi që shkurorëzimi është i lejuar me ligj.

Shkëlzen Feka, anëtar i kuvendit – tha se raporti i auditorit është ai që e shpërfaq më së miri gjendjen në komunë dhe mund të thuhet lirisht se secila drejtori është më mirë se sa që ka qenë më herët, andaj lidhur me këto gjëra duhet të diskutohet mbi bazën e fakteve që dalin nga raporti i auditorit e jo të bëhen akuza paushall dhe të pabazuara.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit – adresoi disa shqetësime të qytetarëve të cilat siç tha ai janë evidente, p.sh rrugët në qytet nuk janë mirë të shënuara, për faktin se mungojnë vijat e bardha të ndarjes dhe vijat kaluese të këmbësorëve, kurse tani që kemi frekuentim të madh të bashkatdhetarëve tanë kemi një kaos në komunikacion. Pastaj kërkesa e banorëve të rrugës “2 Maji” e parashtruar më herët nga ana e tij sikur ka hasur në vesh të shurdhët dhe për këtë kërkoi përgjigje. Pastaj në fshatin Smrekonicë janë disa rrugë siç është rruga “Lutfi Mustafa” dhe rruga “Halit Bejta” për të cilat ka pasur premtime për rregullimin apo kubëzimin e tyre, por me këta qytetarë askush nuk është marrë përpos premtimeve të dhëna në fushata zgjedhore, për këto ai kërkoi që të ofrohet zgjidhje nga ana e komunës. Shqetësim tjetër i adresuar nga ana e tij ishte edhe heqja apo vjedhja e kapakëve të pusetave në rrugë, ku në këto raste po shkaktohet rrezik për qytetarët dhe veturat që qarkullojnë në këto rrugë.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – tha se për hir të opinionit, pasi që kjo mbledhje është duke u transmetuar për publikun, ku shefi i grupit kuvendar të LDK-së, deklaroi se të gjitha drejtoritë komunale, janë më mirë sesa që kanë qenë në mandatin e kaluar, duhet bërë të ditur se faktet flasin ndryshe, dhe kjo përjashton Drejtorinë e Shëndetësisë e cila mund të thuhet se është më mirë sesa mandatin e kaluar, të tjerat kur i shikojmë shpenzimet dalin shumë më keq, por kjo temë mund të trajtohet kur të shqyrtohet raporti financiar. Lidhur me rendin e ditës ai propozoi që pika lidhur me dhënien e pronës në shfrytëzim për kompaninë e ujësjellësit të hiqet nga rendi i ditës pasi kjo lëndë nuk është e kompletuar dhe mungon kërkesa nga institucionet qendrore.

Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së - njoftoi se kërkesa nga ana e MZHE-së lidhur me dhënien e pronës në shfrytëzim, do të procedohet në kuvend gjatë kësaj mbledhjeje, pasi që MZHE është zotuar dhe ka bërë kërkesë për dhënien në shfrytëzim të pronës së komunës, Kompanisë rajonale të ujësjellësit “Mitrovica”.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - duke iu referuar informatës për zbatimin e reformës në fushën e menaxhimit të mbeturinave, gjegjësisht kontesti në mes njësisë së kësaj kompanie të Vushtrrisë me regjionin, vlerësoi se kjo çështje duhet të analizohet mirë duke marrë mendimin e zyrës ligjore për arsye se duhet të merret për bazë opinioni i saj pasi që propozimi që ka ardhur nuk është në përputhje me ligjin sepse kompetencat e Kompanisë regjionale “Uniteti” janë të rregulluara me Ligjin për Shoqëritë Aksionare dhe Ligjin për Ndërmarrjet Publike, andaj vendimet që i ka marrë Komisioni i Aksionarëve të Vushtrrisë janë të kundërligjshme, nuk pasqyrojnë gjendjen reale, për arsye se Kompania “Uniteti” është e themeluar prej tri komunave, ku Komuna e Vushtrrisë bënë pjesë me afër 30 % të aksioneve, mirëpo për të qenë vendimi i ligjshëm i komisionit të aksionarëve, duhet të kemi plotësimin e kushteve ligjore sipas Ligjit për Shoqëritë Aksionare, ku njëra ndër

kushtet është që 45 ditë më herët duhet të thirren përfaqësuesit e shoqërisë aksionare me pikat e rendit të ditës, pastaj duhen 2/3 e votave të aksionarëve të Kompanisë regjionale “Uniteti” për t’u marrë vendime të ligjshme. Në rastin konkret kryetari i komunës i ka sjellë në lajthitje anëtarët e bordit të kompanisë dhe zyrtarët e kësaj kompanie, sepse çështjet për të cilat janë evidentuar në informatë bien jashtë kompetencave, të kryetarit dhe të kuvendit të komunës, kësajsoj është bërë një mishmash i vërtetë dhe për këtë kërkoi një interpretim nga zyra ligjore e komunës.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – kërkoi që të jetë prezent drejtori i Kompanisë “Uniteti” që të japë sqarime para kuvendit pasi ai është në rrjedha të gjërave dhe mund të jetë më i qartë dhe konciz në prezantimin e fakteve për kompaninë dhe funksionimin e saj.

Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore - tha se e ka shqyrtuar materialin lidhur me reformën në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe konstatoj se Komisioni Komunal i Aksionarëve sipas nenit 8, paragrafi 2 të Ligjit të Ndërmarrjeve Publike është i obliguar t’i raportojë kuvendit komunal, dhe me sa ka vërejtur ai ka bërë një rekomandim në atë material voluminoz prej 72 faqeve, del se kuvendi ka të drejtë të nxjerr rekomandim lidhur me ndërmarrjen por jo të marrë vendim.

Në fund të diskutimeve jashtë rendit dhe për rendin e ditës, kuvendi pas votimit me 22 vota “për” 9 vota “kundër” dhe 1 votë “abstenim” aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 27.6.2019;
2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar-qershor 2019;
3. Shqyrtimi i Raportit janar – qershor 2019 për të hyrat dhe shpenzimet;
4. Shqyrtimi i Raportit financiar për vitin 2018 dhe raporti i auditorit;
5. Shqyrtimi i Informatës për zbatimin e vendimeve të kuvendit të komunës për periudhën janar – qershor 2019;
6. Shqyrtimi i Informatës prill – qershor 2019 për sigurinë e produkteve ushqimore;
7. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Administratë;
8. Të ndryshme.
 - a). Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e reformës në fushën e menaxhimit të mbetjeve në Komunën e Vushtrrisë;
 - b). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rrënimin e ish-objektit të TMK-së;
 - c). Shqyrtimi i kërkesë i Federatës të Futbollit të Kosovës, për dhënien në shfrytëzim të stadiumit të futbollit të qytetit të Vushtrrisë;
 - ç). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës komunale për Kompaninë rajonale të Ujësjellësit “Mitrovica SH. A”;
 - d). Shqyrtimit i Informatës për përfundimin e gjysëmjetorit të dytë të vitit shkollor 2018/2019;

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit - arsyetoi se vota kundër për rendin e ditës e grupit kuvendar të PDK-së, është sepse kryesuesi i kuvendit e hedhi në votim një pikë për menaxhimin e mbeturinave, edhe pse zyrtari ligjor sqaroi se ajo pikë është ndesh me ligjin.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 27.6.2019

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - kërkoi që të bëhet plotësimi i diskutimit të kryetarit të komunës, në rastin, kur ai ka deklaruar se anëtari i kuvendit z.Azemi ka qenë anëtar i Bordit të KRM “Uniteti”, gjë kjo e cila nuk është e vërtetë, pasi që ai nuk ka qenë pjesë e këtij bordi ndonjëherë.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit - paraqiti vërejtje lidhur me procesverbalin, në faqen 10, vërejtje të cilat u inkorporuan në procesverbal.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – tha se nëse e lexon procesverbalin e mbledhjes së kaluar të kuvendit, del se në atë mbledhje nuk ka ndodhur asgjë, pastaj sipas vlerësimit të tij në procesverbal nuk kemi pasqyrim objektiv të gjërave që ndodhin apo kemi fshehje të gjërave për të cilat ai nuk i di arsyet.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 27.6.2019, me vërejtjet e paraqitura nga anëtarët e kuvendit.

2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar-qershor 2019

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - pasi përgëzoi punën e Policisë së Kosovës në zonën e Stacionit Policor në Vushtri, për zhvillimin e operativës në hetimin dhe gjetjen e autorëve të krimit, kërkoi informatë nga komandanti i stacionit policor lidhur me keqpërdorimet, korrupsionin, haraçin nga strukturat komunale në Vushtri. Andaj lidhur me këtë pyeti se, zyrtarët policorë çka kanë ndërmarrë në hetimin, zbulimin dhe parandalimin e këtyre veprimeve të kundërligjshme dhe të dënueshme, dhe pyetja e dytë a keni ndërmarrë veprime hetimore nëse po deri ku kanë shkuar këto hetime dhe cilat janë rezultatet. Lidhur me këto çështje ai e di peshën e informacioneve, mirëpo kuvendi e ka mundësinë ligjore dhe me rregullore të punës së kuvendit, kuvendi ka të drejtë që zhvillimin e punimeve ta bëjë në seancë me dyer të mbyllura andaj për këtë kërkoi që të ketë një pauzë, ashtu që të vendoset që mbledhja të zhvillohet pa pjesëmarrjen e publikut nëse aludohet se kemi të bëjmë me zbulimin e informatave konfidenciale dhe dëmtimin e procesit të hetimit.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit - përgëzoi komandantin e Stacionit Policor në Vushtri, për informatën për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar-qershor 2019. Pastaj duke bërë krahasimin e gjendjes së sigurisë të komunës sonë me regjionin e Mitrovicës, ceku se statistikat tregojnë që kriminaliteti në komunën tonë brenda vitit 2019 është rritur, ku janë kryer 941 vepra penale d.m.th. 14.6 vepra penale në 1000 banorë, një shifër kjo që tregon një nivel të lartë të kriminalitetit, ku pjesa më e madhe e këtyre veprave janë vepra penale kundër pasurisë me 547 dhe vepra penale kundër jetës dhe trupit të njeriut. Në Komunën e Mitrovicës statistikat për nivelin e kriminalitetit tregojnë që brenda vitit 2018 në komunë janë kryer 818 d.m.th 11.8 vepra penale për 1000 banorë, shifër kjo që tregon nivel mesatar të kriminalitetit ku edhe këtu pjesa më e madhe e këtyre veprave hyn në grupin e veprave penale kundër pasurisë (419), kurse veprat tjera kundër jetës dhe trupit të njeriut, ndërsa për Komunën e Skënderajt statistikat për nivelin e kriminalitetit flasin që brenda vitit të kaluar në këtë komunë janë kryer 344 vepra penale d.m.th 6.5 vepra penale për 1000 banorë ku pjesa dërrmuese e tyre janë vepra penale kundër pasurisë, si dhe të tjerat janë vepra penale kundër jetës dhe trupit. Në këtë kontekst nëse e vlerësojmë nivelin e kriminalitetit del se Komuna e Vushtrrisë është komuna që ka nivelin më të

lartë të kriminalitetit dhe ajo çka paraqitet si tepër shqetësuese është ekstremizmi i dhunshëm për faktin se në grupet terroriste në Siri dhe Irak i janë bashkëngjitur 10 individë nga Komuna e Vushtrrisë, përkatësisht 0.15 individë për 1000 banorë. Të dhënat për prapavijën personale të këtyre individëve tregojnë që 30 % e tyre kanë pasur të kaluar kriminale, kanë nivel të mesëm dhe të ulët shkollimi dhe janë në një gjendje të mesme ekonomike. Mandej është evidentuar një person që është arrestuar për veprimtari terroriste, i cili ka shkollim universitar dhe në momentin e arrestimit ai ka qenë i punësuar. Në fund tha se nuk evidencë publike që dëshmon që Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë ka mbajtur ndonjë mbledhje për trajtimin e gjendjes së sigurisë.

Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit - pasi e cilësoi informatën për gjendjen e sigurisë si mjaft të kompletuar, njoftoi se grupi kuvendar i LVV-së, do ta përkrah këtë informatë dhe në këtë rast ajo falënderoi komandantin e Stacionit Policor në Vushtrri z.Muhamet Alidema për punën e tij shumëvjeçare dhe pensionimin e tij duke i dëshiruar sukses dhe shëndet.

Melihate Basholli - Latifi, anëtare e kuvendit - pasi falënderoi komandantin e policisë, shtoi se nga mbledhja e fundit e KPF-së është kërkuar nga policia që kjo informatë të vjen në kuvend në formë krahasimtare sa i përket veprave penale, duke krahasuar me vitet paraprake. Tutje ajo falënderoi policinë për bashkëpunimin e treguar me organet e shkollave për rritjen e sigurisë nëpër shkolla. Pastaj pyeti se policët që patrollojnë në rrugë, a kanë të drejtë që të ndalojnë individët në rrugë, të cilët gjuajnë mbetje inerte në lumin “Silnica”, ndërsa inkurajoi që qytetarët që i vërejnë këto dukuri t’i paraqesin në polici këta keqbërës.

Shkëlzen Feka, anëtar i kuvendit – përgëzoi komandantin e Stacionit Policor në Vushtrri për punën e mirë që ka zhvilluar këtyre viteve të fundit, i uroi pensionimin, duke i dëshiruar suksese dhe shëndet.

Muhamet Alidemaj, komandant i stacionit policor - paraqiti sqarime lidhur me informatën në fjalë, duke iu përgjigjur çështjeve të ngritura nga anëtarët e kuvendit dhe duke prezantuar statistika shtesë lidhur me gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – pyeti se a ka delikuentë nga komunat tjera, të cilët po kryejnë vepra penale në komunën tonë, për faktin se kohëve të fundit ka ndodhur një vjedhje në një shtëpi në lagjen e tij dhe kryerësi doli të jetë nga një komunë tjetër.

3. Shqyrtimi i Raportit janar – qershor 2019 për të hyrat dhe shpenzimet

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se auditori i përgjithshëm ka konstatuar rreth 20 shkelje sa i përket financave publike, edhe përkundër faktit se në raport thuhet se pasqyrat financiare janë në pajtim me nenin 45, paragrafët 2 dhe 4 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, mirëpo financat nuk janë përgatit dhe raportuar konform rregullativës ligjore në fuqi. Shqetësuese janë arkëtimet, mandej shpenzimet të cilat janë enorme dhe nëse krahasohen realisht paraqesin një gjendje, gjegjësisht pasqyrë të rëndë për Komunën e Vushtrrisë. Si të tillë këtë raport grupi kuvendar i PDK-së nuk mund ta përkrah, sepse ka shumë mangësi, nuk është në përputhje me kërkesat dhe kriteret, të cilat janë paraparë me buxhet, por edhe me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Mandej jepën disa sqarime të tabelave ku paraqitet planifikimi shpenzimi, shuma e mbetur dhe krahasimi me vitin paraprak dhe ai ka dyshimet e tij se as këto të dhëna nuk janë reale, por janë të manipuluar, duke tentuar që performancën e komunës ta qesin mirë për faktin se ajo fatkeqësisht nuk është ajo që dëshirojmë ne dhe qytetarët tanë. Pastaj shtoi se sa i përket shifrave lidhur me shpenzimet e larta në kategoritë ekonomike, vlen të ceket se rezultatet pozitive në shpenzime kemi pasur vetëm në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, ndërsa në kategoritë si: investime kapitale, mallra dhe shërbime, subvencione dhe

transfere jepen disa shifra të cilat në bazë të metodës së probabilitetit nuk dalin të jenë të sakta. Tek shpenzimet e financimit sipas burimit po ashtu kemi një gjendje të njëjtë, andaj si grup kuvendar nuk do ta votojnë këtë raport.

Shkëlzen Feka, anëtar i kuvendit – tha se duke e parë që ky raport është racional dhe shpërfaq gjendjen reale të shpenzimeve komunale, grupi kuvendar i LDK-së do t'i jap përkrahje të plotë.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 22 vota “për”, 8 vota “kundër” aprovoi Raportin janar – qershor 2019 për të hyrat dhe shpenzimet.

4. Shqyrtimi i Raportit financiar për vitin 2018 dhe raporti i auditorit

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – tha kur flasim për financat e komunës, atëherë duhet t'i referohemi fakteve të pasqyruara në raportin e auditorit të përgjithshëm, i cili ndër të tjera ka nxjerr këto mangësi: tek planifikimi dhe realizimi i buxhetit, auditori thotë se kemi keqklasifikim të shpenzimeve, tek të hyrat dobësi në menaxhimin e të dhënave në tatimin në pronë, tek pagat dhe mëditjet dobësi në udhëheqjen e procedurave të rekrutimit, çështje kjo për të cilin ai vazhdimisht ka qenë konsistent në publikimin e të metave në lidhjen e marrëveshjeve për shërbime të veçanta, praktikë kjo e cila është duke vazhduar aktualisht në Komunën e Vushtrrisë. Pastaj tek mallrat dhe shërbimet kemi mangësi në menaxhimin e kontratave; vonesa në liferimin e mallrave; tek subvencionet dobësi në menaxhimin e tyre; tek investimet kapitale auditori ka vërejtur se kemi mungesë të projektit ekzistues, vonesa në realizimin e projekteve kapitale; ndryshimi i kushteve të kontratës gjatë përmbushjes së saj. Mandej tek çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet dhe investimet kapitale; pagesat e ekzekutuara nga thesari për vendimet gjyqësore; tek pasuritë kapitale dhe jokapitale, dobësi në menaxhimin e pasurive; tek të arkëtueshmet rritja e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme; tek obligimet e papaguara, vonesa në pagesat e obligimeve, në të cilat çështje, mund të ketë implikime financiare në vitin fiskal vijues; dobësi në kontrollat menaxheriale, raportim jo i mirë mbi shpenzimet.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se Zyra Kombëtare e Auditimit ka gjetur një varg parregullsish për vitin 2018 në Komunën e Vushtrrisë dhe atë si në vijim:

1. Keqklasifikimi i shpenzimeve;
2. Dobësitë në menaxhimin e të dhënave në tatimin në pronë;
3. Dobësi në udhëheqjen e procedurave të rekrutimit;
4. Mangësi të marrëveshjet për shërbime të veçanta;
5. Mangësi në menaxhimin e kontratave;
6. Pagesa nga kategoritë ekonomike joadekuate si: shpenzimet e ekzekutuara nga thesari në vlerë prej 97,617€ kishin të bënin me keqklasifikime pasi që nga investimet kapitale ishin paguar paga të punonjësve të arsimit;
7. Shpenzimet për investime kapitale në vlerë prej 10,109€ që kishin të bënin me projektin kapital “Renovimi i objekteve të QMF-ve dhe instalimi i ngrohjeve qendrore” ishte paguar gabimisht nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve;
8. Dobësitë në menaxhimin e të dhënave në tatimin në pronë. Nga mostrat e testuara për pajtueshmërinë me rregulloret mbi vlerësimin e bazës tatimore, auditori ka identifikuar dobësitë në vijim: në dy nga dhjetë raste nuk ishin aplikuar normat adekuate të vlerësimit të bazës tatimore sipas koeficientëve të kualitetit bazuar në nenin 5 pika (1.8.1) të UA 03/20118;

9. Në tri raste në mungesë të numrit personal në sistem (Protax) nuk kemi mundur t'i identifikojmë përfituesit që kanë më shumë se një pronë dhe që kanë përfituar më shumë se një herë prej zbritjes lidhur me vendbanimin kryesor, bazuar në Ligjin nr 03/L-204;

10. Dobësi në udhëheqjen e procedurave të rekrutimit. Në procesin e rekrutimit për mësues klase dhe mësimdhënës për edukatë fizike, është kërkuar ndër tjera edhe vërtetimi i përvojës së punës dhe certifikatat e trajnimeve. Gjatë testimit të lëndëve identifikua se të përzgjedhurit nuk i kishin plotësuar këto kritere. Për më tepër edhe komisioni vlerësues nuk kishte mbajtur evidenca për vlerësimin/poentimin individual për kandidatët, por me një procesverbal ishte përmbledh i tërë procesi. Dobësitë e identifikuar janë shkaktuar nga neglizhenca, pakujdesia dhe kompetenca jo e duhur e komisioneve për ta kryer punën;

11. Mangësitë të marrëveshjet për shërbime të veçanta. Komuna e Vushtrrisë gjatë vitit 2018 kishte të angazhuar 38 punonjës me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta. Për të gjitha rastet fillimisht janë përdorë procedura të thjeshtësuara të rekrutimit, përderisa për 23 prej tyre iu kishte vazhduar kontrata edhe për gjashtë muaj tjerë, me kërkesë nga drejtoritë përkatëse ku ishin të angazhuar;

12. Mangësitë në menaxhimin e kontratave. Auditori ka identifikuar se në lëndë mungojnë raportet e menaxherëve të kontratës, si në rastet e mëposhtme: te dy pagesa në vlerë prej 10,879€ për kontratën “Furnizim me karburante dhe vaj për automjete, ngrohje dhe gjeneratorë” dhe te tri pagesa në vlerë prej 5,153€ për kontratën nga AQP “Furnizim me karburante për nevoja të A.K” mungonin raportet e menaxherëve të kontratës që e konfirmojnë pranimin, dhe te pagesa në vlerë prej 240€ për kontratën “Sigurimi i automjeteve” po ashtu mungonin këto raporte;

13. Vonesat në liferimin e mallrave. Auditori ka vërejtur se në tri kontrata (shtatë pagesa) kishte vonesa në liferim të mallrave dhe nuk janë aplikuar ndëshkime të përcaktuara në kontratë për rastet e mëposhtme. “Në tri pagesa në vlerë prej 103,150€ për “Furnizim me lëndë djegëse – dru për ngrohje për nevoja të A.K – Vushtri”, vonesat ishin nga 15 deri në 50 ditë përtej afatit të përcaktuar dhjetëditorë me kontratë, në dy pagesa në vlerë prej 12,497€ për kontratën “Furnizim me material shpenzues dhe reagensa për laborator të QKMF-ve” vonesat ishin nga 20 deri në 170 ditë mbi afatin e përcaktuar pesëditorë me kontratë, si dhe në dy pagesa në vlerë prej 2,197€ për kontratën “Furnizim me material për mirëmbajtjen e objekteve të A.K Vushtri” vonesat ishin nga 19 dhe 37 ditë mbi afatin e përcaktuar treditorë me kontratë”. Arsyeja e vonesave ishte menaxhimi jo i duhur i kërkesave për furnizim nga komuna dhe mosaplikimi i penaleve;

14. Dobësitë në menaxhimin e subvencioneve. Auditori ka gjetur shumë dobësi në menaxhimin e subvencioneve, të cilat kishin të bënin me mangësitë në përcaktimin e kritereve për aplikim dhe monitorimin e tyre si: te dhënia e subvencioneve për “makinë për konservimin e barit – rrotoballer” dhe “për përfitim të serrave të tipit tunel prej 2 ari”, ka vërejtur së në të dy thirrjet për aplikim nuk ishin kërkuar kritere të matshme dhe specifike për përzgjedhjen e përfituesve potencial. “Kjo ka bërë që pothuajse të gjithë aplikantët të plotësojnë kriteret, andaj nga komisioni kanë ardhur në shprehje nën kritere tjera për selektim, që nuk ishin të shkruara. Për më tepër, për aplikantët e refuzuar me arsyen që kanë qenë përfitues në vitet e mëparshme, zyrtarët nuk kanë arritur të na dëshmojnë këtë vlerësim;

15. Dy pagesa në vlerë prej 13,000€ të përfituesve përmes Thirrjes publike për financim të projekteve të personave juridik-OJQ, ne kemi vërejtur që përfituesit nuk kanë raportuar sipas nenit (4) të kontratës mbi bazën e raportimeve tremujore dhe gjysmëvjetore të zbatimit të projektit. Raportimi ishte kryer pas përfundimit të projektit dhe atë jo për tërë shumën e përftuar, dhe në një rast të subvencionimit për ndihmë personit fizik në vlerë prej 3,000€, përfituesi nuk ka raportuar në bazë të nenit 2.2.2 të marrëveshjes për mbikëqyrjen e shfrytëzimit të mjeteve, i cili parasheh

raportimin e shpenzimeve të mjeteve nga ana e përfituesit pas 45 ditëve të përfitimit të subvencionit”, konstaton raporti;

16. Vonesat në realizimin e projekteve kapitale. Në kushtet e veçanta të kontratave të punës ishte definuar afati për realizimin e punimeve. “Në projektet e mëposhtme identifikua vonesa në realizimin e projekteve si: kontrata “Asfaltimi i rrugës lokale Vushtri Sllatinë” në vlerë prej 173,319€ e datës 24.9.2018, ishte paraparë të përfundojë më datë 25.11.2018 (vonesa – 60 ditë kalendarike);

17. Kontrata “Asfaltimi i nëntë rrugëve lokale të Komunës së Vushtrrisë” në vlerë prej 128,234€, e datës 31.10.2018, ishte paraparë të përfundojë më datë 3.1.2019 (vonesa – 40 ditë pune);

18. Asfaltimi i rrugëve në 14 fshatrat e Komunës së Vushtrrisë – llot, asfaltimi i rrugëve në shtatë fshatra në vlerë 133,535€ e datës 31.7.2018, ishte paraparë të përfundojë më datë 11.12.2018 (vonesa – 90 ditë pune). Në të gjitha projektet e lartpërmendura punët nuk kishin përfunduar deri në kohën sa ne ishim në auditim 29.3.2019;

19. Rishikimi në realizimin e projekteve të cilat ishin trajtuar si vonesa në raportin e auditimit të vitit 2017. Te projekti “Renovimi i shtëpisë së Mahmut agë Gjinollit” kemi vërejtur se punët ende nuk kishin përfunduar, përkundër që ky projekt ishte paraparë të përfundonte më 4.12.2017.”, thuhet në raport;

20. Dobësitë në menaxhimin e pasurive. Në tri raste pasuritë e blera nuk ishin regjistruar në sistemin e SIMFK-së si: pagesa për “Furnizim me automjet terreni për nevojat e QKMF-së” me vlerë 27,950€, e datës 20.11.2018; pagesa për “Renovimi i objekteve të QMF-ve dhe instalimi i ngrohjes qendrore” me vlerë 10,109€, e datës 24.12.2018 dhe pagesa për “Renovimi i shkollave fillore dhe të mesme në Komunën e Vushtrrisë” me vlerë 3,311€, e datës 11.9.2018.

Gjithashtu, mangësi janë vërejtur edhe në menaxhimin e sistemit E-pasuria pasi për disa pasuri nuk është kalkuluar fare zhvlerësimi. Auditorit për Komunën e Vushtrrisë për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018 gjen shkelje të shumta ligjore e parregullsi, andaj ftoi prokurorin e shtetit të hetojë të gjitha të gjeturat e auditorit dhe të zgjerojë hetimet sepse auditori ka marrë vetëm disa mostra për të cilat ka hartuar raportin.

Shkëlzen Feka, anëtar i kuvendit - tha se kur bëjmë vlerësime dhe kualifikime të çështjeve komunale nuk duhet të udhëhiqemi nga inatet politike, por duhet të iu referohemi fakteve, e faktet i ka publikuar auditori që ka dhënë vlerësimin për pasqyrat financiare të Komunës së Vushtrrisë me “opinionin e pamodifikuar me theksim të çështjes” dhe ky është vlerësim tepër i lartë sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitet për financat publike. Pastaj prej 26 rekomandimeve që kemi pasur në këtë raport, 16 prej tyre janë adresuar, ndërsa në masën prej 90 % të rekomandimeve janë realizuar dhe kjo është një performancë e jashtëzakonshme për Komunën e Vushtrrisë. Pastaj shtoi se anëtari i kuvendit z.Azemi në vitin 2015 nuk e kontestonte raportin e auditorit, edhe pse atëherë kishte pasur mjaft të gjetura negative për komunën.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se edhe në mandatin e kaluar kur partia të cilës ai i takon ka qenë në pushtet, ai gjithëherë ka bërë vërejtjet dhe kritikën e tij ku ka menduar se ka pasur shkelje, dhe kështu ai ka qenë zëri i vetëm opozitar në kuvend edhe pse ka qenë PDK-ja në pushtet, ndërsa ai z. Feka nuk e ka ngritur kurrë zërin për asnjë çështje kjo mund të verifikohet shumë lehtë përmes procesverbaleve të mbledhjeve.

Afrim Namani, drejtor i DA-së - sqaroi se bazuar në udhëzimet administrative, për kandidatët për mësimdhënës në procedurën e konkursit, kërkohen edhe vërtetimi për përvojën e punës dhe certifikatat e trajnimeve. Një çështje tjetër të cilën e ngriti është se udhëzimet administrative për rekrutimin e stafit mësimor nuk i nxjerr Ministria e Arsimit, por një ministri tjetër që nuk e ka

kompetencën profesionale, pasi shumica e atyre njerëzve nuk kanë punuar në sistemin arsimor, dhe ato udhëzime janë jofunksionale.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - vlerësoi se auditori i përgjithshëm vetëm sa e ka konfirmuar se, Drejtoria e Arsimit nuk ka vendosur kritere të matshme sa i përket zhvillimit të procedurave të rekrutimit në fushën e arsimit. Pasi që nëse në konkurs janë kërkuar njerëz me përvojë pune dhe ata nuk i kemi, atëherë duhet të anulohet konkursi dhe të shpallet me kushte tjera, e që në fakt kjo i bie që janë bërë pazare dhe tregtim me vende pune në lëmin e arsimit. Kjo për faktin se janë përzgjedhur kandidatë pa i përfillur kriteret e konkursit dhe seleksionuar kandidatët, e kjo nënkupton se kemi shkelje të institucionit të konkursit dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare.

Afrim Namani, drejtor i DA-së - tha se Drejtoria e Arsimit nuk vendos kritere punësimi, përderisa ekziston normativi dhe kjo i bie se drejtoria i merr copy/paste kriteret që dalin nga udhëzimet administrative dhe ato i shpall në konkurs. Lidhur me pazaret që aludohet me vende pune, ceku se nëse ai ka bërë pazare, atëherë urdhëroni dhe bashkë i procedojmë ato në organet e drejtësisë dhe këto çështje le të marrin epilog deri në pikën e fundit, por pa fakte mos të akuzohet dhe të përmbahemi nga fjalori etiketues ndaj personave zyrtarë pa fakte e argumente. Normativi përcakton se edhe në rastet kur nuk kemi të kualifikuar, atëherë mund të pranohen mësimdhënës edhe pa diplomë.

Lutfi Gërguri, drejtor i DBF-së - tha se të dhënat në raport janë plotësisht të sakta sa i përket shpenzimeve komunale, ndërsa sa i përket raportit të auditorit ai është i pamodifikuar me theksim të çështjes, e që i bie se kemi shënuar progres për faktin se vitin paraprak kemi pasur 21 të gjetura, tani janë 16. Në vitin 2017 niveli i zbatimit të rekomandimeve të auditorit ka qenë 40%, kurse për vitin 2018 është 52%. Lidhur me keqklasifikimin e shpenzimeve tha se kjo është një dukuri e cila na përcjell vit pas viti, për shkak të mungesës së subvencioneve ndodhin pagesa nga kategoritë tjera ekonomike, siç janë mallrat dhe shërbimet. Menaxhimi i tatimit në pronë bëhet nga Departamenti i Tatimit në Pronë në Ministrinë e Financave sipas sistemit Protax, por si pasojë e mosmarrjes së numrave të letërnjoftimit në momentin e regjistrimit të pronës dhe kështu kemi pasur shënime jo të sakta në identifikimin e pronave.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se nga letra që ka lexuar dhe bashkëngjitur procesverbalit më herët, del se auditori gjeneral ka konstatuar gjithsej të përmbledhura 20 shkelje, por nga këto 20 shkelje dalin edhe 200 shkelje tjera, dhe për këtë ai kërkon që prokuroria e shtetit të merr për bazë raportin e auditorit, që të nisë hetim zyrtar dhe t'i zgjerojë hetimet sepse auditori nuk ka mundur të bëjë identifikimin dhe konstatimin e të gjitha shkeljeve që kanë ndodhur.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 22 vota "për" aprovoi Raportin financiar për vitin 2018 dhe raportin e auditorit.

5. Shqyrtimi i Informatës për zbatimin e vendimeve të kuvendit të komunës për periudhën janar – qershor 2019

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – tha se kjo informatë është kompletuar nga administrata komunale, duke u inkorporuar rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa.

6. Shqyrtimi i Informatës prill – qershor 2019 për sigurinë e produkteve ushqimore

7. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Administratë

8. Të ndryshme.

a). Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e reformës në fushën e menaxhimit të mbetjeve në Komunën e Vushtrrisë

Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit - tha se kur bëhet fjalë për menaxhimin e mbeturinave, tashmë qytetarët janë dëshmitarët më të mirë të një pune të shkëlqyer që ka bërë Drejtoria e Shërbimeve Publike me drejtorin e kaluar z.Sedat Rashica e për të vazhduar me drejtorin aktual z.Refik Maloku. Për herë të parë në Vushtrri falë bashkëpunimit me GIZ-in gjerman janë mbuluar me kontejnerë mbi 50 fshatra të komunës sonë dhe gjitha lagjet e qytetit me mbi 15,000 ekonomi familjare, të cilave u merren mbeturinat. Aktualisht të papajisura me kontejnerë janë edhe 17 fshatra, 6 prej të cilave janë shumë pak të banuara apo fare të pabanuara. Vlen të theksohet se në dy vitet e fundit janë shpërndarë mbi 5000 kontejnerë për ekonomi familjare dhe kjo është një tregim sukcesi për komunën tonë e cila falë menaxhimit të mirë të mbeturinave ka fituar edhe grant qeveritar dhe është shpall një nga komunat me pastërtinë më të lartë. Pengesat që kanë dal kohëve të fundit me KRM “Uniteti” selia qendrore nuk do të mund t’ia zbeh imazhin e mirë kësaj pune të mirë që është bërë deri më tani nga drejtoria përkatëse dhe nga njësia e kompanisë “Uniteti” në Vushtrri me përkrahjen e institucioneve lokale. Duhet falënderuar drejtorin e njësisë së “Unitetit” z.Fadil Bahtiri, i cili përkundër kërcënimeve me shkarkim e ndëshkim nga menaxhmenti i KRM “Uniteti” në Mitrovicë, po vazhdon t’i mbledh mbeturinat në territorin e komunës sonë. Si grup kuvendar i LVV-së ndërprejten e ofrimit të shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave nga KRM “Uniteti” për territorin e Komunës së Vushtrrisë e shohin si tendencioze dhe me prapavijë. Konsiderojnë se punët e mira dhe në interes të qytetarëve duhet të përkrahen me çdo kusht dhe jo të sabotohen nga ana e askujt.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – tha se, edhe përkundër që dispozitat e Ligjit për Mbeturinat parashohin bazë ligjore për liberalizimin e sektorit të mbeturinave, duke hapur tregun për operatorët privat në menaxhimin e mbeturinave, ende dominojnë ndërmarrjet publike që operojnë dhe de-facto ofrojnë shërbime të menaxhimit të mbeturinave për komunat. Ligji kryesor që rregullon sektorin e mbeturinave në Kosovë është Ligji nr. 04/L-060 “Ligji për mbeturinat” dhe është ligj special, që nënkupton që kur dy apo më tepër ligje rregullojnë gjendjen faktike të njëjtë apo të ngjashme, ligji që rregullon një qëllim të veçantë (ligji special) mbizotëron ndaj një ligji që rregullon vetëm çështjet e përgjithshme (ligji gjeneral). Kjo doktrinë e ligjit special është veçanërisht e rëndësishme kur shpjegohet rregullimi i sektorit të mbeturinave në Kosovë në raport me ligjet e tjera, (p.sh. Ligji për Ndërmarrjet Publike dhe Ligji për Shoqëritë Tregtare). (në këtë rast ka të drejtë kryetari). Mos të harrojmë se edhe Ligji për Vetëqeverisjen Lokale përcakton menaxhimin e mbeturinave si kompetencë e plotë dhe ekskluzive e komunave. Por tek Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturinat, neni 34 -Menaxhimi i mbeturinave komunale, paragrafi 8. Menaxhimi i mbeturinave komunale nga komuna duhet të bëhet përmes kontratave të veçanta me një apo më shumë operatorë publik ose privat të licencuar për menaxhimin e mbeturinave. Njësia Operative në Vushtrri nuk ka subjektivitet juridik (në këtë rast mund të ketë të drejtë kryeshefi i KRM “Uniteti”. Në bazë të asaj çka kam lexuar, Prizreni ka ecur para komunave tjera për këtë çështje, konsideroj se është mirë që drejtori i SHP dhe shefi i njësisë KRM “Uniteti” të shkojnë deri në Prizren për konsultime. Përndryshe, kjo që po i rekomandoni Kuvendit Komunal që me marr vendim për pavarësimin e njësisë së KRM “Uniteti” ne edhe mund të marrim një vendim të tillë, por konsideroj se nuk ka kurrfarë baze ligjore thënë qartë do te ishte vendim koti.

Melihate Basholli – Latifi, anëtare e kuvendit - tha se të gjithë jemi në dijeni se është bërë një punë e madhe në fushën e ambientit, gjegjësisht në menaxhimin e mbeturinave, duke filluar nga miratimi i rregulloreve dhe planeve, implementimin e reformës dhe menaxhimin e mbetjeve. Ky mekanizëm ligjor, duke përfshirë kalimin e inkasimit në komunë dhe kontraktimin e shërbimeve është bërë në vitet paraprake dhe tashmë kur qytetarët janë ambientuar me rregullat e menaxhimit të mbeturinave dhe kur ata përkrahin rregullat e menaxhimit të mbetjeve, tani kur vërehet edhe vetëdijesimi i qytetarëve në këtë aspekt, na vjen si kontrast një letër e dërguar në adresën e Bordit të Kompanisë “Uniteti” që jo vetëm që e pengon punën e tij, por rrezikon punëtorët dhe tërë reformën që është bërë në fushën e menaxhimit të mbeturinave që prej vitesh. Andaj ajo konsideron se qeveria komunale është përgjegjëse për këtë çështje dhe kërkon që sa më shpejt të bëjë zgjidhje, sepse është çështje jetike për qytetarët.

Shkëlzen Feka, anëtar i kuvendit - tha se të gjithë pajtohem se është bërë një punë e mirë në menaxhimin e mbeturinave në njësinë e “Unitetit” në Vushtrri, dhe si duket kjo duket është duke i penguar. Por megjithëkëtë ai propozon që kuvendi të nxjerrë një rekomandim që në asnjë formë të mos bllokohet e drejta jonë për dërgimin e mbeturinave në deponinë e Gërmovës dhe të shteren të gjitha mundësitë duke konsultuar edhe ministrin për të jap një sqarim se si mund të dalim nga kjo situatë.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit - vlerësoi se njësia e Kompanisë “Uniteti” në Vushtrri ka bërë një punë të shkëlqyeshme, por në këtë aspekt duhet t’i përgëzojmë edhe qytetarët të cilët janë vetëdijesuar dhe atë në nivel të regjionit qytetarët tanë bëjnë pagesën më së miri. Ajo që na gëzon është fakti se qytetarët e Vushtrrisë e kanë të ngulitur në kokë se po bëhet një punë e mirë dhe po realizohet pagesa nga ana e tyre. Pastaj ceku se ka që dy apo tri mbledhje që është debatuar rreth kësaj çështjeje dhe i bie që kësaj i ka paraprirë dikush, dhe se asnjë grupacion politik nuk duhet të ketë inate kur bëhet një punë e mirë. Tutje shtoi se është mirë që udhëheqësit komunal të dalin në një konferencë për media që të sqarohet opinioni për bllokadat që kanë ndodhur në menaxhimin e mbeturinave, duke informuar se njësia e Kompanisë “Uniteti” në Vushtrri është në rregull, se qytetarët janë duke bërë pagesën dhe të shikohen mundësitë ligjore për kapërcimin e kësaj çështjeje, si dhe të sqarohet saktësisht se kush është ai i cili e ka bllokuar këtë proces. Tutje ai vlerësoi se nëse vazhdohet me këto avaze, atëherë do vjen puna deri tek ndërprerja e mbledhjes së mbeturinave dhe qytetari do ta ketë shumë vështirë ta kuptoj se kush në fakt e ka fajin për mosmbledhjen dhe bartjen e mbeturinave, sepse ai paguan në komunë për mbeturina dhe e di që komuna është përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave, andaj lidhur me këtë çështje përsëriti se është mirë të sqarohet opinioni duke dal me një komunikatë apo konferencë për media. Në fund ai kërkoi që 50 ekonomi familjare në fshatin Stanoc i Epërm të furnizohen me kontejnerë pasi ata paguajnë mbeturinat me rregull, por nuk janë pajisur me kontejnerë.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit - tha se kur bëhet fjalë për menaxhimin e mbeturinave, atëherë është mirë që kjo çështje të diskutohet shtruar nga të gjithë, pasi që kjo çështje është me interes të përgjithshëm për qytetarët tanë. Tutje shtoi se nëse dëshirojmë të jemi real dhe ta trajtojmë mirë këtë çështje, atëherë duhet të kthehemi në retrospektivë dhe të shikojmë që çështjen e menaxhimit të mirë të mbeturinave e ka filluar PDK-ja, atëherë kur e ka marrë iniciativën për aprovimin e Rregullores dhe planit për menaxhimin e mbeturinave në kuvend në vitin 2015. Pastaj ai si ish-kryesues i kuvendit ka nënshkruar vendimin për aprovimin e buxhetit të komunës në vitin 2017, ku janë planifikuar mjetet financiare për procesin e menaxhimit të mbeturinave. Tani ajo çka po kërkon Partia Demokratike e Kosovës në Vushtrri është të respektohen dispozitat ligjore dhe mos të ketë ndërhyrje politike dhe këtë e kanë kërkuar edhe mbledhjen e kaluar. Lidhur me këtë çështje ai kërkoi që të gjendet një zgjidhje për ta kapërcyer së bashku këtë problematikë dhe

kërkoi që edhe anëtari i Bordit, por edhe kryeshefi ekzekutiv i Kompanisë “Uniteti” të japin sqarime për kuvendin, në mënyrë që të kemi një ballafaqim me fakte se a ka shkelje ligjore sa i përket kontraktimit të shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – iu apeloj anëtarëve të grupit kuvendar të LVV-së që “mos të hedhin benzinë në zjarr” por të angazhohen në mënyrë konstruktive për gjetjen e një zgjidhjeje për menaxhimin e mbeturinave. Kjo për faktin se ekziston Ligji për Menaxhimin e Mbeturinave si ligj special që rregullon këtë materie, dhe për më shumë Kompania “Uniteti” është kompani aksionare rajonale, dhe nuk mund që vetëm një komunë në mënyrë të njëanshme të imponojë dhe diktojë vendosjen për çështje me rëndësi. Në fund apeloj që mos të tentohet të politizohet kjo çështje, por të angazhohemi të gjithë në gjetjen e një zgjidhjeje.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se para disa muajsh e kishte identifikuar dhe në mënyrë të vazhdueshme e kishte përsëritur, se kryetari i komunës e kishte lidhur një kontratë me një person të paautorizuar me çka ka vënë në pikëpyetje bazën ligjore të transfereve të mjeteve që janë kryer për arsye se është luajtur një lojë jokorrekte për faktin se nuk mund të pavarësohet në mënyrë të njëanshme njësia as e Vushtrrisë as e Skënderajt dhe as ajo e Mitrovicës, për arsye se Ligji mbi Shoqëritë Aksionare e përcakton se si mund të bëhet bashkimi në shoqëri aksionare dhe se si bëhet ndarja, mandej zvogëlimi i kapitalit, rritja e kapitalit, cilat kritere duhet të plotësohen. Aktualisht kemi para vetës një kontratë që e ka përgatitur komuna, marrëveshje për shërbime primare të menaxhimit të mbeturinave në territorin e Komunës së Vushtrrisë mes kësaj të fundit dhe KRM “Unitetit”, të cilën e përfaqëson personi kompetent kryeshefi ekzekutiv Gazmend Morina, deri tash sa ai është në dijeni nuk është lidhur konform ligjit asnjë kontratë, për faktin se ato janë nënshkruar nga personi jokompetent siç është menaxheri i njësies së “Unitetit” në Vushtri. Kompania regjionale “Uniteti” është një e vetme cila ka një numër fiskal, me një numër të biznesit, është obligues tatimor e vetmja në administratën tatimore, por edhe para organeve tjera përfaqësuese ligjore e vetme, dhe këtu nuk mund të shpiket ndonjë njësi e cila do të kishte subjektivitet për të nënshkruar kontrata apo marrëveshje. K.R.M “Uniteti” ka të drejtë të themelojë edhe dy njësi në Vushtri nëse e sheh të arsyeshme dhe të nevojshme, por kjo çështje është në kompetencën e K.R.M “Uniteti” e jo të Komunës së Vushtrrisë. Andaj forma se si është menduar me ushtruar presion, duke mbajtur dhunshëm punën, njësia në Vushtri nuk është as e ligjshme dhe as e duhur për arsye se ka ardhur shkresa që njofton se përfaqësuesit e aksionarëve kanë marrë vendim dhe kështu është vu në lajthitje anëtari i bordit, i cili ka nënshkruar, sido që të jetë komisioni i aksionarëve nuk e ka kompetencën që të nënshkruajë, për faktin se ata e kanë rolin vetëm të përfaqësuesit. Në kontekst të nxjerrjes së një vendimi të ligjshëm duhet të thirret mbledhja në mënyrë të rregullt dhe nevojiten 2/3 e Bordit të Aksionarëve të të tri komunave Mitrovicës, Vushtrrisë dhe Skënderajt. Thënë në mënyrë lakonike KRM “Uniteti” është subjekt juridik unik, i cili i kryen shërbimet e menaxhimit të mbeturinave për të tri komunat, e cila e bartë përgjegjësinë penale-juridike dhe përgjegjësinë tjetër, pagat lëshohen prej Kompanisë regjionale “Uniteti” dhe në të kaluarën kur njëra njësi nuk ka pasur mjete për mbulimin e pagave, ato janë siguruar nga njësia tjetër. Kjo është kështu pasi që komuna në asnjë rast nuk ka të dejtë t’i përzihet në organizimin e brendshëm KRM “Uniteti”. Në fund kërkoi që të hiqet nga marrëveshja neni 17, dhe t’i jepet fjala kryeshefit ekzekutiv që të jap sqarimet e nevojshme ashtu që të gjendet një zgjidhje oportune, që ofrohen shërbimet e menaxhimit të mbeturinave dhe të rrjedhin pagesat.

Shkëlzen Feka, anëtar i kuvendit - tha se më habit fakti se si dikujt po i pengon suksesi i njësies së Kompanisë “Uniteti” të Vushtrrisë dhe mohohet raporti i auditorit lidhur me këtë kompani. Ai vlerësoi se është e nevojshme që të mbetet në fuqi neni 17 i marrëveshjes, pasi që është në interes

të qytetarëve që paratë e inkasuara nga ata të shfrytëzohen në Komunën e Vushtrrisë për avancimin e procesit të menaxhimit të mbeturinave në komunën tonë.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit - tha se është mirë dhe i gëzohet faktit që procesi i menaxhimit të mbeturinave është duke shkuar mirë, proces ky i filluar nga Partia Demokratike e Kosovës - Dega në Vushtri, por megjithëkëtë atyre ju intereson baza ligjore e cila duhet respektuar, për më shumë duhet t'i jepet fjala kryeshefit ekzekutiv që të jap sqarimet e nevojshme.

Ismet Gashi, udhëheqës i Zyrës ligjore - tha se pika 7 e këtyre rekomandimeve nuk duhet të merret parasysh për shkak se kuvendi nuk merr vendim për ndarjen, por vendimin për themelim duhet ta dërgojmë në Njësinë për politika dhe monitorim të ndërmarrjeve publike, e cila është e përcaktuar dhe e themeluar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, për këtë rast është themeluar një komision për t'i filluar punët rreth kësaj çështjeje. Ai tërhoqi vëmendjen se kuvendi nuk ka kompetencë të marrë vendime për ndarjen e njësisë së Kompanisë "Uniteti".

Refik Maloku, drejtor i DSHP-së - tha se dëshiron të jap sqarime lidhur me procesin e menaxhimit të mbeturinave, por pa ngjyrimet politike, dhe shtoi se pastërtia e qytetit karakterizohet me punën e shkëlqyeshme të stafit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe kjo është e evidente. Tutje shtoi se kontestuese në marrëveshjen për shërbime primare sa i përket menaxhimit të mbeturinave është neni 17 i saj, por kjo ka qenë edhe më herët, nuk është se është shpikur ndonjë gjë e re në këtë relacion. Neni 17 si dihet parashihet që paratë e inkasuara të shfrytëzohen për ngritjen e njësisë së "Unitetit" në Vushtri, duke u pajtuar që njësia t'i kryejë të gjitha obligimet që dalin nga regjioni si kompani aksionare. Pastaj bazuar në marrëveshjen e sipërcekur, del obligimi se KRM "Uniteti" do të vazhdojë me ofrimin e shërbimeve në grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave deri në arritjen e një marrëveshjeje të përbashkët. Në vazhdim ai dha sqarime kronologjike lidhur me komunikimin zyrtar për tejkalimin e mosmarrëveshjes me KRM "Uniteti" dhe lexoi para anëtarëve të kuvendit përgjigjen e kthyer nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, konkretisht Njësia për politika dhe monitorim të ndërmarrjeve publike.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - tha se aktualisht ndodhemi në një situatë kur KRM "Uniteti" në mënyrë të kundërligjshme ka bllokuar derdhjen e mbeturinave në Deponinë e Gërmovës. Pastaj shtoi se Komuna e Vushtrrisë ka një mosmarrëveshje me KRM "Unitetin", për kontratën, por deri në gjetjen e një zgjidhjeje për këtë kontest, askush nuk ka të drejtë dhe nuk guxon të dëmtojë qytetarët, gjë këtë të cilën e ka konfirmuar edhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Andaj ndalja e qasjes në Deponinë e Gërmovës, e ka bllokuar në tërësi menaxhimin e mbeturinave dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Në këtë kontekst ai vlerësoi se komunës është duke iu bërë shantazh, duke u kushtëzuar nga "Uniteti" ose pranoje kontratën pa nenin 17 ose do të ndalet ofrimi i shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave nga KRM "Uniteti". Tutje përsëriti se kontestuese është neni 17 i kontratës, i cili ka qenë në fuqi edhe më herët e deri më datë 1 korrik 2019. Ky nen thotë që: paratë e inkasuara nga Komuna e Vushtrrisë, fillimisht të përdoren për ngritjen e kapaciteteve të njësisë së "Unitetit" Vushtri dhe pastaj bordi është i lirë që t'i zhvillojë politikën e kompanisë sepse komuna jonë nuk përzihet në politikën e bordit të kompanisë, por si komunë kemi obligim që të mbrojmë interesin e komunës dhe interesin tonë si aksionarë në atë kompani. Andaj në situatën aktuale që gjendemi, nëse kuvendi vlerëson që paratë e inkasuara nga Komuna e Vushtrrisë, nuk duhet të përdoren për ngritjen e njësisë së Vushtrrisë, por ato duhet të përdoren për pastrimin e rrugëve nga bora në Mitrovicë, siç edhe ka ndodhur, atëherë kësaj po lejojmë që të dëmtohet interesi i njësisë së Kompanisë "Uniteti" në Vushtri. Bllokimi i qasjes në Deponinë e Gërmovës është një veprim skandaloz dhe ka konsekuenca për shkaktimin e rrezikut të përgjithshëm në dëmtimin e shëndetit publik të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë. Kur është fjala për Deponinë e Gërmovës, kjo deponi është e licencuar për tri komunat për Mitrovicën,

Vushtrinë dhe Skënderajin, edhe pse toka ku është vendosur është në pronësi të Komunës së Mitrovicës, menaxhimin e deponisë e bënë Komuna e Mitrovicës e jo Njësia qendrore për menaxhimin e deponive, sepse në bazë të ligjit kjo njësi i menaxhon të gjitha deponitë e Kosovës përveç asaj të Mitrovicës (Gërmovës), të cilën e menaxhon Komuna e Mitrovicës përmes KRM “Uniteti”, e thënë në mënyrë lakonike edhe në Deponinë e Gërmovës, Komuna e Vushtrrisë është aksionare. Por deri në sqarimin e kësaj situatë, nëse ka konteste duhet shkuar edhe në rrugë gjyqësore, duke kërkuar vendime gjyqësore për këtë çështje se kush ka të drejtë. Prandaj përfundoi se kjo kontratë e mbron interesin e njësisë tonë dhe interesin e përgjithshëm qytetar. Në këtë relacion kërkoi nga kuvendi që të aprovojë një rekomandim, ku të kërkohet që në radhë të parë të deblokohet Deponia e Gërmovës, të mos merren masa ndaj zyrtarëve të njësisë së Kompanisë “Uniteti” Vushtrri, por të lihen të lirë në marrjen e vendimeve në të mirë të kompanisë dhe të qytetarëve në kontekst të menaxhimit të mbeturinave. Në fund kërkoi nga kuvendi që të angazhohet për gjetjen e një zgjidhjeje për kapërcimin e kësaj problematike për deblokimin e deponisë dhe për vazhdimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët në bartjen dhe grumbullimin e mbeturinave.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se anëtari i Bordit të Kompanisë “Uniteti” z.Agim Krasniqi është personi kredibil, andaj atij duhet t’i jepet fjala që të japë sqarime, në kontekst të asaj se përse ka votuar bordi për ndërprerjen e ofrimit të shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave për Komunën e Vushtrrisë dhe a ka votuar edhe z.Krasniqi për ndërprerjen e këtyre shërbimeve. Vendimet e bordit të Kompanisë “Uniteti” janë të obligueshme për kryeshefin ekzekutiv të kësaj kompanie, andaj duhet të sqarohet se si janë marrë vendimet në bord lidhur me çështjen e ndërprerjes së ofrimit të shërbimeve për mbeturinat.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – tha se vullneti i anëtarëve të kuvendit është që të dëgjohet edhe pala e kundërt. Në këtë rast argumentet e kryeshefit ekzekutiv të Kompanisë “Uniteti” duhet të prezantohen para kuvendit dhe kryesuesi i kuvendit nuk e ka të drejtë që t’ia mohojë diskutimin e tij në kuvend.

Agim Krasniqi, anëtar i Komisionit të aksionarëve të KRM. “Uniteti”- paraqiti sqarime para anëtarëve të kuvendit, ku njoftoi se në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nuk ka obligim ligjor që t’i përgjigjet pyetjeve të anëtarëve të kuvendit, por i përgjigjet Komisionit të Aksionarëve, ndërsa kuvendit i jep llogari drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe anëtarët e komisionit të aksionarëve.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit - tha se për ta qartësuar këtë situatë duhet t’i jepet fjala për të diskutuar kryeshefit ekzekutiv të KRM “Unitetit”, sepse askush nuk ka të drejtë të i’a mohojë të drejtën e fjalës. Ai është person kompetent dhe duhet t’i prezantojë argumentet e tij para kuvendit. Është evidentet se problemi qëndron tek KRM “Uniteti” e jo tek njësia e kësaj kompanie në Vushtrri, dhe për këtë duhet të angazhohemi të gjithë për ta gjetur një zgjidhje për kapërcimin e kësaj situatë. Pastaj vlerësoi se ai rekomandim për të cilin po bëhet gjithë kjo zhurmë, mund edhe të aprovohet po le ta dinë të gjithë se ai është në kundërshtim me ligjin sepse askush nuk guxon dhe nuk ka të drejtë të interfrojë në ndërmarrjet publike. Andaj ftoi të gjithë që të jenë konstruktiv në gjetjen e një zgjidhjeje oportune për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 21 vota “për” të tjerat “abstenim” aprovoi këtë:

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë 25 korrik 2019, pas shqyrtimit të Informatës lidhur me aktivitetet për implementim të reformës në fushën e menaxhimit të mbetjeve në Komunën e Vushtrrisë, dhe pas një debati substancial, lidhur me gjendjen e përgjithshme në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave “Uniteti” SH.A Mitrovicë miraton këtë:

REKOMANDIM

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë i rekomandon kryeshefit ekzekutiv dhe Bordit të drejtorëve të KRM “Uniteti” në Mitrovicë, që të heqin dorë nga veprimet e njëanshme për ndalimin e ofrimit të shërbimeve në pastrimin, grumbullimin dhe transportin e mbeturinave për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë. Të deblokohet deponia e grumbullimit të mbeturinave në Germovë dhe që njësisë së KRM “Uniteti” në Vushtrri t’i mundësohet qasja në këtë deponi. Gjithashtu kuvendi rekomandon që paratë e derdhura nga komuna për njësinë e KRM “Uniteti” në Vushtrri, të përdoren vetëm për interesat dhe nevojat e njësisë të KRM “Uniteti” në Vushtrri. Kjo është me rëndësi për zhvillimin e njësisë në Vushtrri, ku Komuna e Vushtrrisë është pronare e aseteve, siguron pagat e punëtorëve dhe kushtet për punë, si dhe garantimin e shërbimeve më cilësore nga njësia në Vushtrri. Po ashtu kuvendi rekomandon që neni 17 i Marrëveshjes për Shërbimet Primare të Menaxhimit të Mbeturinave në Territorin e Komunës së Vushtrrisë të mbesë në fuqi ashtu siç ka qenë deri më tani.

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë i inkurajon palët e involvuara në këtë proces që të shprehin gatishmërinë e tyre për gjetjen e një zgjidhjeje të përshtatshme dhe të bazuar në ligjet pozitive, ashtu që të mbrohet interesi i qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.

b). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rrënimin e ish-objektit të TMK-së

Gresa Muli, anëtare e kuvendit - pyeti se ku do të vendoset biblioteka e qytetit, pasi që ky objekt të rrënohet, a ka siguruar vend komuna, pasi që është shqetësues fakti se tani është pushim në Universitetin e Prishtinës, dhe studentët nuk mund t’i shfrytëzojnë sallat e leximit atje.

Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së - kërkoi nga kuvendi që të plotësojë propozim-vendimin në fjalë, përkatësisht në pikën 1 të shtohet fjalia me kulturë tokë - ndërtimore. Lidhur me stabilimentin e objektit ceku se për vlerësimin e tij është themeluar një komision ku për këtë është hartuar raport dhe është konstatuar gjendja faktike e objektit në fjalë.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit - tha se më herët është marr një vendim për ndërtimin e një qendre të mjekësisë po në këtë parcelë, por kjo çështje është prolonguar pasi që është vlerësuar se kjo qendër është shumë afër asaj ekzistueses, por edhe për faktin se në bazë të strategjisë për zhvillimin e konceptit të mjekësisë familjare, ndërtimi i një qendre të mjekësisë duhet të bëhet bazuar në kriterin demografik në një zonë ku gravitojnë 10000 banorë. Lidhur me këtë çështje ai kërkoi që të bëhet një analizë më e thellë pasi kjo është çështje shumë serioze që ndikon në përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore. Pastaj shtoi se në të kaluarën ndërtimi i objekteve të mjekësisë familjare ka qenë i imponuar prej faktorëve të shkatërrimit nga lufta, por edhe ai i donacioneve ndërkombëtare, kurse tani pasi i kemi paratë nuk është mirë të ngutemi, por duhet të ndërtojmë një objekt që i përgjigjet realizimit të konceptit të mjekësisë familjare. Tutje ceku se ai vend ku është menduar të ndërtohet ajo godinë, nuk është shumë i përshtatshëm pasi që afër është shkolla dhe

distanca gjeografike nga qendra ekzistuese është e shkurtër. Në kontekst të kësaj propozoi që parcela ku ndodhet aktualisht Qendra e mjekësisë familjare duhet t'i jepet spitalit, ndërsa Ministria e Shëndetësisë duhet t'i jap një pronë për ndërtimin e një qendre të mjekësisë familjare një vend më të përshtatshëm. Mandej pyeti se projekti për ndërtimin e qendrës së re të mjekësisë familjare a është projekt dyvjeçar, a është bërë projekti, kur do të fillojë dhe kush është punëkryesi

Sylejman Mehulli, drejtor i DSHPS-së - tha se vendimi për përcaktimin e lokacionit të ndërtimit të QMF-së së re është marr në muajin shtator 2018, kurse sot ka ardhur propozimi për rrënim dhe përshtatje të hapësirës të vendit ekzistues, që është caktuar vitin e kaluar. Tutje shtoi se është evidente se komuna ka mungesë të pronave në pronësi komunale dedikuar zhvillimit të infrastrukturës, ngritjes së godinave publike, siç është ajo për ndërtimin e Qendrës së mjekësisë familjare. Në fund tha se tentativa për ta gjetur një lokacion tjetër për ndërtimin e kësaj qendre shkakton rrezik në buxhet që ai të shkojë në suficit nëse projekti nuk fillon të zhvillohet deri në fund të këtij viti.

Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së - sqaroi se i kemi pasur dy alternativa për vendosjen e kësaj qendre mjekësore dhe atë lokacioni tek “Ura e Vjetër e Gurit” dhe te objekti i ish-TMK-së. Për shkak të hapësirës së ngushtë dhe formës së parregullt të parcelës nuk i ka plotësuar kushtet. Andaj në lokacionin tek objekti i ish-TMK-së është përcaktuar lokacioni për ndërtimin e kësaj qendre, projekti është hartuar nga Drejtoria e Urbanizmit konform kërkesave të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe ai objekt do të jetë sipas standardeve moderne.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovet propozimi për rrënim të objektit, i regjistruar në ngastrën kadastrale nr. P-70202016-02358-12, me kulturë ndërtimore, në sipërfaqe prej 1400 m², Zona Kadastrale Vushtrri (ish-objekti i TMK-së në Rr. “Skënderbeu” në Vushtrri), pronë e Komunës së Vushtrrisë.

2. Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të zbatojë procedurat për rrënim të objektit të cekur në pikën paraprake dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, konform dispozitave ligjore në fuqi.

3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

c). Shqyrtimi i kërkesë i Federatës së Futbollit të Kosovës, për dhënien në shfrytëzim të stadiumit të futbollit të qytetit të Vushtrrisë

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – tha se të dy subjektet si Federata e Futbollit të Kosovës, por edhe klubi i futbollit “Vushtrria” nuk kanë të drejtë të jenë titullar të kërkesë për marrjen në shfrytëzim sipas procedurës së veçantë të kësaj prone, bazuar në Ligjin për Dhënien e Pronës në Shfrytëzim. Në qoftë se vendoset që kjo pronë të jepet në shfrytëzim, atëherë në kontratë duhet të futet një nen i veçantë ku përcakton se: në rast të privatizimit të klubit të futbollit, parcela ku është i vendosur stadiumi i kthehet me automatizëm Komunës së Vushtrrisë.

Ismet Gashi, udhëheqës i Zyrës ligjore - tha se dhënia e pronës në shfrytëzim duhet të bëhet konform Ligjit për Dhënien e Pronës në Shfrytëzim, konkretisht nenit 21 ku parashihen rastet e veçanta të dhënies së pronës në shfrytëzim pa u zhvilluar konkurrenca. Në rastin konkret klubi, por edhe Federata e Futbollit, duhen t'i adresohen me kërkesë Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kurse kjo e fundit ka të dejtë të kërkojë nga Komuna e Vushtrrisë që në procedurë të veçantë t'i jepet kjo pronë në shfrytëzim.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë 25 korrik 2019, ka shqyrtuar kërkesën e Federatës të Futbollit të Kosovës dhe të Klubit të Futbollit KF “Vushtrria”, lidhur me dhënien në shfrytëzim të stadiumit të qytetit të Vushtrrisë për periudhën prej 25 vjet, respektivisht 40 vjet, në ç’rast jep këtë përgjigje:

Dhënia e pronës komunale në shfrytëzim rregullohet me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe atë duke u bazuar në parimin e konkurrencës dhe mbrojtjes së interesit të përgjithshëm të komunës, andaj duke u bazuar në nenin 21 të ligjit të sipërcekur ku përjashtohen procedurat e konkurrencës, kërkesa në fjalë për dhënien e pronës në shfrytëzim duhet të bëhet nga institucionet qendrore të Republikës së Kosovës, konkretisht nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport.

ç). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës komunale për Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit “Mitrovica SH. A”

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - propozoi që para se të jepet në shfrytëzim kjo pronë të mbahet një mbledhje me komunitetin e atij lokaliteti, ku do të njoftoheshin me vendimin e marr nga kuvendi dhe për projektin e ujësjellësit. Mandej shtoi se vendimet nuk duhet të merren në mënyrë centraliste, por duhet të merret mendimi i qytetarëve, sepse vetëm kështu mënjanohe problemet dhe pakënaqësitë e tyre.

Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së - njoftoi kuvendin se përfaqësuesit e komunitetit lokal ku do të zhvillohet ky projekt i ka informuar dhe se ata janë pajtuar me vendosjen e stabilimenteve të Kompanisë rajonale të ujësjellësit “Mitrovica SH. A”, pasi që kjo është në të mirën e tyre dhe të vetë kompanisë. Tutje sqaroi se vendosja e këtij stabilimenti do të bëhet në mënyrë profesionale, ku pjesa e rezervarit dhe stacionit të pompimit do të vendoset nën tokë dhe kjo nuk do të ketë ndonjë pengesë apo problematikë në terren.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite e pronës së paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë në ngastrën kadastrale nr.P-70202046-01033-0, Zona Kadastrale Maxhunaj, pronë e Komunës së Vushtrrisë, me kulturë kullosë e klasës së dytë (2), me sipërfaqe prej 4434m², ku nga sipërfaqja e përgjithshme jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 210.00m².

2. Prona e cekur si në pikën 1 të këtij vendimi jepet në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite Kompanisë rajonale të ujësjellësit “Mitrovica” Sh.A, për ndërtimin e rezervuarit nëntokësor me vëllim $V=180.00m^3$ apo dimensionet (12.40X6.50m) sipas projektit të prezantuar - objekti me rrethojë i cili do të shfrytëzohet hapësirën prej 210.00m².

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

4. Pjesë e këtij vendimi janë: certifikatat e pronësisë, kopja e planit dhe skicat e projektit.

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

d). Shqyrtimit i Informatës për përfundimin e gjysëmvetorit të dytë të vitit shkollor 2018/2019

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit - duke iu referuar informatës në fjalë pyeti drejtorin e arsimit, se a ka ndonjë informatë se sa është përqindja e nxënësve të klasave të para që nuk dinë shkrim lexim. Pastaj ceku se në informatë është dashur të evidentohet, realizmi i vizitave sistematike të më se 4000 nxënësve, të cilët i janë nënshtruar kontrolleve të ndryshme, dhe këto vizita janë mbikëqyrur nga Drejtoria e Shëndetësisë. Rëndësia e këtyre vizitave shëndetësore është tepër e madhe, dhe kjo dëshmohet nga fakti se që nga viti 2015 kur kanë filluar këto vizita është dal rezultati se fëmijët në klasën e parë në vitin 2019 kanë pasur anomali të syve në masën prej 20%, kurse kjo statistikë tani ka ra në 8%.

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit - kërkoi nga Drejtoria e Arsimit, që të procedojë me ndryshimin e rregullores për bursa, pasi që në të shihen mjaft shumë mangësi, ku 14 studentë kanë fituar bursë me automatizëm. Mandej apeloj që tek studentët që fitojnë bursë nga ndonjë organizatë, që mos të kërkojnë financim nga komuna, ashtu që edhe studentëve tjerë t’u lihet mundësia për ofrimin e ndihmës financiare.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit - shtroi temën e ndarjes së nxënësve në shkollën SH.M.U 1 nga grupi kur ata kalojnë nga klasa e 5 në klasën 6, kjo ndarje bëhet ashtu që kombinimi bëhet 5 nxënës të mirë dhe 5 nxënës jo të mirë, dhe kjo nuk dihet se sa është produktive dhe që i motivon nxënësit pasi që në shumicën e vendeve kemi grumbullim të nxënësve të mirë me qëllim të rritjes së konkurrencës.

Afrim Namani, drejtor i DA-së - paraqiti sqarime lidhur me informatën, duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit, ku ceku se për numrin e nxënësve që nuk kanë arritur të përvetësojnë shkrim leximin, nëse bazohemi në raportin e suksesit që na është sjell, atëherë del se asnjë nxënës nuk kemi që nuk di shkrim lexim edhe pse ky informim është vetëm për gjysmëvetorin e dytë. Sa i përket vizitave sistematike nëpër shkolla e kam falënderuar drejtorin e shëndetësisë dhe ju kërkoi falje për këtë lëshim, herëve tjera do ta kemi parasysh. Sa i përket çështjes së bursave, këtë rregullore e cila është në fuqi duhet respektuar, mirëpo pasi janë konstatuar shumë mangësi duhet iniciuar ndryshim- plotësimi i saj. Studentët që i fitojnë bursat automatike i kanë kriteret që duhet plotësuar. Bursat për studime jashtë: Drejtoria e Arsimit në kuadër të subvencioneve dhe transfereve i ka 3 linja buxhetore: 1. Bursa për studentë, 2. Transporti i fëmijët me nevoja të veçanta dhe 3. Përkrahja e nxënësve dhe studentëve në arritjet e rezultateve të larta. Lidhur me përzierjen e nxënësve nëpër klasa, të nxënësve të dobët, mesatar dhe ata me

rezultate të larta, mund të thuhet se nga praktika ka dalë si metodë e suksesshme pasi ka rezultuar më produktive në sukseset dhe njohuritë e nxënësve. Kjo metodë në instancë të fundit mund të mbetet edhe si çështje e brendshme e shkollës.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit - pyeti se a ka raportime në Drejtorinë e Arsimit nga drejtorët e shkollave fillore në Prelluzhë dhe Gracë, për numrin e nxënësve të klasave V dhe IX të komunitetit serb dhe komuniteteve tjera. Mandej Drejtoria e Arsimit a bënë pagesën e mësimdhënësve dhe a ka realisht kontroll mbi ato shkolla dhe se me çfarë planë-programesh punojnë ato. Tutje shtroi çështjen e inicimit të themelimit të paraleleve të klasave të mjekësisë në shkollat e mesme për faktin se janë afër 100 nxënës në drejtimin e mjekësisë, të cilët shkojnë në shkollat e Komunës së Mitrovicës dhe të Prishtinës, ku atje i kryejnë mësimet teorike, ndërsa pjesën praktike e kryejnë në ordinancat dhe spitalin e Komunës së Vushtrrisë. Në këtë kontekst nëse ka pasur nevojë që të hapet drejtimi për përpunimin e drurit në shkollën e mesme ku kemi një paralele me afër 20 nxënës, atëherë shumë e nevojshme është hapja e paraleles së mjekësisë ku do të kemi të paktën dy apo tri klasë, ku do të regjistroheshin nxënësit me suksese të dalluara. Pastaj pyeti se sa është numri i nxënësve që janë regjistruar në tri shkollat e mesme si ajo teknike, profesionale dhe gjimnazi, si dhe si ka shkuar ky proces. Pastaj vuri në pah se nga raportet që janë ofruar del se pas kontrolleve të policisë së Kosovës sidomos në shkollat e mesme është evidentuar se tek disa nxënës janë gjetur armë, andaj pyeti se ndaj këtyre nxënësve a është ndërmarr ndonjë masë ndëshkuese, po ashtu edhe disa mësimdhënës nuk kanë sjellje të mira qoftë në shkollat fillore apo të mesme dhe Drejtoria e Arsimit a ka ndërmarr ndonjë masë ndaj tyre.

Abdullah Vojvoda, anëtar i kuvendit - e përkrahi idenë që në shkollat tona të hapen dy apo tri paralele në drejtimin e mjekësisë në mënyrë që nxënësit tanë mos të udhëtojnë qoftë në Prishtinë apo në Mitrovicë, andaj nëse ka bazë ligjore është e udhës që të themelohen këto paralele.

Afrim Namani, drejtor i DA-së - njoftoi se shkollat të cilat janë nën autoritetin e Komunës së Vushtrrisë nuk ka nxënës të komuniteteve pakicë, shkolla e fshatit Prelluzhë dhe ajo e Gracës nuk i raporton Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Vushtrrisë, dhe se kjo e fundit nuk paguan mësimdhënësit e këtyre shkollave, drejtorët e këtyre shkollave kanë ardhur në komunë, por ata nuk janë trajtuar si persona zyrtarë, pasi ata nuk janë emëruar sipas dispozitave ligjore dhe sistemit juridik të Republikës së Kosovës. Sa i përket çështjes së paraleleve të mjekësisë që numri i nxënësve për dy paralele kishte me qenë afërsisht 50 nxënës më shumë në totalin e nxënësve. Shkolla e mjekësisë është shkollë profesionale, d.m.th është arsim profesional, andaj në kushtet aktuale të ekonomisë, profilet e reja të drejtimeve në shkollat profesionale hapen sipas kushteve dhe kërkesave të ekonomisë dhe tregut të punës. Sa i përket profilit të përpunimit të drurit në shkollën profesionale, drejtim i cili ka filluar nga viti i kaluar, mund të thuhet se për këtë profil ka kërkesa nga tregu i punës. Lidhur me numrin e nxënësve të regjistruar në klasat e X, ku i takon gjendjes të pas qershorit, por për të pasur statistika të sakta duhet pritur afati i dytë i regjistrimit të nxënësve. Në këtë kontekst përveç shkollës profesionale “Bahri Haxha” që është një numër i mirë i nxënësve, situata nuk është e mirë as në gjimnaz, sepse afër dy paralele të planifikuara ato nuk janë plotësuar, por që pritet që kjo të bëhet në afatin e dytë. Pastaj vlerësoi se këto dy vitet e fundit numri i planifikuar i nxënësve në paralele apo numri i nxënësve nëpër klasa ka ardhur duke u zvogëluar, me qëllim që t’u jepet prioritet drejtimeve në shkollat profesionale. Për të bërë fillimin e organizimit të profilit të paraleleve të mjekësisë duhet filluar këtë vit për të mund që kjo të realizohet pas 3 viteve pasi që nevojitet të bëhet rekrutimi i kuadrit arsimor pasi që ai staf duhet të jetë nga profili i mjekëve. Për nxënësit që janë kapur duke bartur me vete gjësende të ndaluara apo armë qoftë të ftohta apo të nxehta gjatë kontrolleve policore, ndaj atyre nxënësve janë shqiptuar masa disiplinore konform rregulloreve në fuqi. Po ashtu edhe ndaj mësimdhënësve që kanë

keqpërdorur detyrën zyrtare janë ndërmarr masa konkrete disiplinore, administrative dhe gjyqësore.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit - tha se themelimi i profilit të mjekësisë si shkollë profesionale është i domosdoshëm, madje tepër i nevojshëm dhe i arsyeshëm, por për këtë duhet të shikohet ana ligjore duke u konsultuar edhe ministrinë gjegjëse. Pastaj shtoi se duhet të identifikohet se sa nxënës në drejtimin e mjekësisë kemi që udhëtojnë në Mitrovicë dhe Prishtinë. Lidhur me kuadrin arsimor në lëmin e mjekësisë, vlerësoi se ky staf do të mund të angazhohej nga doktorët e spitalit dhe të QKMF- pasi në këtë institucion nxënësit e kryejnë anën praktike. Lidhur me kërkesat e tregut të punës ai arsyetoi se kërkesa për këtë lëmi është tepër e madhe marrë për bazë plakjen e kuadrit shëndetësor dhe migrimin e tyre jashtë vendit dhe nga kjo rrezikohemi të mbesim pa kuadër shëndetësor. Andaj nëse këtë e lejon ligji do të ishte mirë që të themelohej një paralele në drejtimin e mjekësisë. Në fund tha se raportimi për vizitat sistematike shëndetësore nëpër shkolla është obligim ligjor e jo çështje që mbetet në dëshirën apo vullnetin e ndokujt.


Mbledhja përfundoi në ora 15:10.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit

